



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

*Adresa: Rr. Abdi Toptani" nr.2, Tiranë;*

*E-mail: klsh.org.al; Web-site:www.klsh.org.al*

Nr. 401/6 Prot.

Tiranë, më 30/09/2019

**V E N D I M**

**Nr. 109, Datë 30.09.2019**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MJEDISIT, TIRANË, "MBI PËRPUTHSHMËRINË E AKTIVITETIT TË INSTITUCIONIT", për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 31.05.2019.**

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Tiranë rezultoi që, veprimtaria e subjektit të audituar, në drejtim të çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit të institucionit për procedurat e monitorimit, vet-monitorimit të subjekteve me ndikim në mjedis nga ndotja dhe dëmtimi, procedurën ligjore në dhënien e akt-miratime/refuzime të lejeve tipi (A dhe B), zbatimit të projekteve të ndryshme mjedisore publike, vlerësimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit ekonomiko-financiar, nuk ka qenë plotësisht efektive, si rrjedhojë e mangësive në zbatimin e procedurave në përputhje me kuadrin ligjor dhe mungesës së bashkëpunimit me institucionet e tjera që kontribuojnë në aktivitetin e kësaj njësie.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë dhe Sekretari i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**VENDOSA**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi auditimin e përputhshmërisë të aktivitetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", në procedurat e monitorimit, vet-monitorimit të subjekteve me ndikim në mjedis nga ndotja dhe dëmtimi, procedurën ligjore në dhënien e akt-miratime/refuzime të lejeve tipi (A dhe B)", të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, sipas programit të auditimit nr.401/1, datë 03.06.2019, për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 31.05.2019.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes, Opinionin e Auditimit dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## A. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

**Baza për opinionin e kundërt për përputhshmërinë e aktivitetit të AKM, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:**

KLSH ka audituar veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe ISSAI 1700<sup>1</sup>, dhe ISSAI 4000<sup>2</sup>, për vlerësimin nëse aktiviteti i AKM-së është kryer në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet/investimet vjetore të buxhetit, zbatimit të projekteve të ndryshme për monitorimin e mjedisit, zbatimin e kuadrit ligjor për dhënien e akt-miratimeve për lejet mjedisore të tipit (A) dhe (B), si edhe kuadrin tjetër ligjor dhe rregullator për përdorimin e burimeve financiare nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

*Nga auditimi mbi përputhshmërinë:* Nga auditimi janë konstatuar parregullsi në zbatimin e dispozitave të prokurimit publik; mosrespektim të kuadrit ligjor për dhënien e akt-miratimeve për lejet mjedisore të tipit (A) dhe (B), dobësi në zbatimin e buxhetit, etj., si më poshtë vijon:

Nga AKM në 16 raste nuk janë respektuar procedurat ligjore të përcaktuara në VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të Tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, të ndryshuar, në shqyrtimin dhe akt-miratimin e aplikimeve të bëra për pajisjen me leje mjedisore të tipit A dhe B.

-Nga AKM për vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018 nuk është respektuar procedura ligjore e përcaktuar në kundërshtim me Kap.III, pika 40-45 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Programit”; pika 46-48 “Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit”, si dhe pika 49-55 “Përgjegjësitë e nëpunësit zbatues”, të Udhëzimit nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, në lidhje me respektimin e dy fazave nëpër të cilat kalon përgatitja e projekt buxhetor afatmesëm, si dhe në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimet vjetore plotësuese “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm”, për hartimin e projekt-buxheteve afatmesëm.

- Nga AKM për muajin Dhjetor të viteve 2015-2018 është vepruar në kundërshtim me pikën nr.151, të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe pikës 3, Kreu I, të Udhëzimeve plotësuese vjetore “Për zbatimin e buxhetit”, për mosrespektimin e prioritetit të radhës për pagesat e shpenzimeve të institucionit, të faturave të energjisë elektrike, uj, telefon, posta, etj.

- Procedurat për marrjen në dorëzim të aktiveve (grante brenda sistemit dhe jashtë tij) për vitet 2015, 2017 dhe 2018, konkretisht: Aparaturë e tipit “TESTO”, viti **2015** në vlerën **1,187,760 lekë**; USB-së për përdorim dhe nënshkrim elektronik në vlerën **7,800 lekë**, si dhe Kompjuter PC (3 copë), Monitor (3copë) dhe UPS (3 copë) në vlerën **368,313 lekë** totali, për vitin **2017**; Materialeve laboratorike nga projekti IBECA (mostra certifikuese referenc, kapa, standarte laborator, helium, argon, azot, acid klorhidrik) në vlerën **3,041,353 lekë** totali si dhe materialeve elektrike, program kompjuterik (1 copë), kompjuter philips (1 copë), aparat fotografik dixhital sony (6 copë), video-projektor (1 copë), laptop (1 copë), aparat dore GPS (6 copë), në total

<sup>1</sup> **ISSAI 1700**- Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

<sup>2</sup> **ISSAI 4000** – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

**3,965,484 lekë** për vitin **2018**, nuk janë kryer në përputhje me përcaktimet e bëra në Aneksin 1, klasa 2, “Aktivet afatgjata”, të Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, me pikën 42, 43, 55 dhe 56 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Për periudhën **Janar-Mars 2015** janë shpenzuar në mënyrë të padrejtë shpenzime për dieta në vlerën 33,000 lekë, për punonjësit e AKM-së, duke shkaktuar dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, të cilat kanë pasaktësi në dokumentacion dhe shërbime të paguara për punonjës të paautorizuar, në programet e punës të miratuar nga Titullari i AKM-së, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën b, pika 35 dhe pika 36 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, si dhe me përcaktimet e bëra në shkronjën b, pika 3, KREU III, dhe KREU IV, të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar.

- Nuk është respektuar detyrimi i kontratës nga ISHP për dorëzimin e raportit teknik të pjesshëm në datën 05.06.2017, për të cilën nga AKM nuk është vendosur asnjë penalitet, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit, e për rrjedhojë konsiderohet dëm ekonomik në vlerën 174,606 lekë, konkretisht: 22 ditë vonesë (5 Qershor – 5 Korrik data tjetër e dorëzimit të raportit) \*  $(4/1000 * 1,984,160 \text{ lekë}) = 174,606 \text{ lekë}$ .

-Për kontratën nr.107 (monitorimi i erozionit të tokës), me vlerë financimi **700,000 lekë**, UBT ka dorëzuar raportin financiar përfundimtar në datën **16.12.2015**, dhe jo sipas afatit të përcaktuar në kontratë, në datën **01.12.2018**, pra **11** ditë pune me vonesë. Për këtë veprim të UBT, nga AKM duhet të ishte llogaritur penalitet në vlerën: 11 ditë vonesë \*  $(4/1000 * 700,000 \text{ lekë}) = \mathbf{30,800 \text{ lekë}}$ , vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

-Në 3 raste konstatohet se subjektet që kanë riaplikuar për leje mjedisore kanë paraqitur si mandat pagese mandatin e aplikimit për të cilën AKM më parë është shprehur me “Refuzim” të lejes mjedisore. Vlerësojmë se jemi përpara mos përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në pikën 3/a të VKM 417, datë 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve mjedisore” nga ana e subjekteve "B.G", "E" dhe “J.F”. mos përmbushja e detyrimeve të përcaktuara në VKM 417/2014 në vlerën 130,000 lekë përbën të ardhur të munguar për buxhetin e shtetit, me efekt dëm ekonomik.

-Në prokurimin publik me objekt “**Për mirëmbajtjen e pajisjeve të monitorit**” për vitin 2016, me fond limit 8,187,578 lekë pa tvsh, KVO ka vepruar në papajtueshmëri me nenet 20, 23, 24, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu VII i VKM nr.914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke kualifikuar ofertues i cili nuk i plotëson kriteret për kualifikim. KVO nuk duhet të kishte shpallur fitues OE “K” dhe njëherazi duhet të kishte anuluar procedurën e prokurimit. Nga veprimet dhe mosveprimet e KVO, është shkaktuar përdorim i fondeve publike me efekt financiar negativ në vlerën 8,186,060 lekë pa tvsh.

- AKM ka vepruar në kundërshtim me pikën 62, të Udhëzimit nr.2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja “gj” të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, për mos ekzekutimin e vendimeve të gjykatës, të formës së prerë, për 3 punonjësit e larguar nga puna, **z.F.C** 3.8 paga, **znj.A.M** 15.7 paga dhe **z.D.K** 19.7 paga, duke krijuar edhe efekt negativ financiar në vlerën **129,792.5 lekë** në buxhetin e shtetit nga tatimi mbi të ardhurat e tyre i pa ndalur.

- Në 8 raste, referuar regjistrimit të raportimeve, 8 subjekte të cilët janë pajisur me Leje Mjedisore të Tipit A, nuk kanë raportuar për shkarkimin e ndotësve, sipas kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore të miratuar për subjektin.

-Nga AKM nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar ISHMPU, me qëllim vendosjen e penaltetit për mosrespektimin e kushteve të lejes nga subjektet "E" shpk, "V" shpk, "A" shpk, "V.M" shpk, "F" shpk; "B.G" shpk; "T.A.T.M" shpk, "R.E.P" shpk. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 1/a, neni 69, të Ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", duke krijuar të ardhura të

munguara për buxhetin e shtetit në vlerën rreth 135,900,000 lekë, për mos përmbushjen e kushteve të lejes mjedisore.

-Në 1 rast, subjekti “A”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi B, me nr. *Identifikimi të Lejes*, sipas Akt-miratimit nr.5595, datë 01.09.2016, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: *“Nxjerrje e mineraleve, rërës, argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret”*. Nga auditimi i kësaj dosje konstatohet se Aplikimi i bërë për rishikim të kushteve të lejes mjedisore Tipi B viti 2010, është pranuar nga AKM jashtë afatit 2 vjeçar për paraqitjen e kërkesave për rishikim të kushteve të lejes të subjekteve ekzistuese në kundërshtim me pikën 2 e nenit 30 të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 *“Për lejet e mjedisit”*.

-Për vitet 2015-2018, u konstatua se vlerat e aktiveve të institucionit, të pasqyruara në raportet e inventarizimit 2015-2018 dhe pasqyrat financiare 2015-2018, kanë diferenca në vlerat, si vijon: **4,130,209 lekë**-viti 2015; **2,863,426 lekë**-viti 2016; **1,394,216 lekë**-viti 2017; **1,839,945 lekë**-viti 2018, të cilat rezultuan në llogarinë 214 “instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, si dhe në llogarinë 31, 32, 33, klasa 3 “gjëndja e inventarit”, ku në pasqyrat financiare ishin kontabilizuar me vlerë më të ulët në krahasim me vlerat e inventarit. Gjithashtu rezultoi se në asnjë prej viteve 2015-2018, nga komisionet repsektive të inventarizimit të aktiveve të AKM-së, nuk janë pasqyruar diferencat dhe më pas të mbaheshin procesverbalet për këto diferenca, duke vepruar në kundërshtim me pikën 85, shkronja “b” dhe “c” të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar.

-Për periudhën 2015-2018 është konstatuar se vlera e detyrimeve të AKM-së, pasqyruar në Pasqyrat Financiare sipas përlllogaritjeve të bëra nga institucioni janë të gabuara dhe nuk pasqyrojnë informacion të saktë dhe real, në kundërshtim me Ligjin *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* dhe Udhëzimin të Ministrisë së Financave *“Për procedurat e përgatitjes dhe mbylljes së pasqyrave financiare për institucionet qendrore, njësitë e qeverisjes vendore, njësitë e tyre të varësisë dhe njësitë e zbatimit/implementimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë huaj”*

**Viti 2015.** Vlera e detyrimeve të AKM-së, pasqyruar në Pasqyrën Financiare viti 2015, sipas përlllogaritjeve të bëra nga institucioni në vlerën **3,470,261 lekë**, sipas përlllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit, vlera totale e detyrimeve është **7,553,754 lekë**.

**Viti 2016.** Vlera e detyrimeve të AKM-së, pasqyruar në Pasqyrën Financiare sipas përlllogaritjeve të bëra nga institucioni në vlerën **3,532,365 lekë**, sipas përlllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit, vlera totale e të drejtave është **4,424,750 lekë**.

**Viti 2017.** Vlera e detyrimeve të AKM-së, pasqyruar në Pasqyrën Financiare sipas përlllogaritjeve të bëra nga institucioni në vlerën **4,317,213 lekë**, sipas përlllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit, vlera totale e të drejtave është **4,636,073 lekë**.

**Viti 2018.** Vlera e detyrimeve të AKM-së, pasqyruar në Pasqyrën Financiare sipas përlllogaritjeve të bëra nga institucioni në vlerën **4,297,896 lekë**, sipas përlllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit, vlera totale e të drejtave është **5,186,320 lekë**.

### **Opinion i kundërt mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së AKM<sup>3</sup>**

*Sipas opinionin tonë, mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, aktiviteti i kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e buxhetit dhe prokurimeve, dhënien e akt-miratimeve për lejet mjedisore përgjatë periudhës 2015- 6*

<sup>3</sup> Sipas **Manualit të Auditimit Përputhshmërisë** të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.4, **Konkluzionet/opinionet e kualifikuara:** Audituesi shpreh një konkluzion me rezervë kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit. Kur auditimi i përputhshmërisë kryhet së bashku me pasqyrat financiare, audituesi mund të shpreh një opinion me rezervë kur devijimet janë materiale por jo të përhapura, ose n.q.s. audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencë auditimit të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe, efektet e mundshme, janë materiale por jo të përhapura.

muajori i parë 2019, nuk ka qenë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, kuadrin ligjor në fushën e mjedisit, si dhe ligjet për procedurat e prokurimit publik dhe rregulloret respektive, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura.

Ne besojmë se evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të kundërt.

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr.254/7, datë 30.06.2015, nuk është zbatuar rekomandimi nr.10: “Nga AKM duhet që në deklaratimet për periudhat në vazhdim, të cilat bëhen brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, në plotësim të kërkesave ligjore të dorëzohë pyetësin e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, së bashku me deklaratën dhe raportin e cilësisë”. (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.16-23, të Raportit të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Titullari i AKM-së për rekomandimin nr.10 të auditimit të mëparshëm, të marrë masat e nevojshme që në çdo vit të përgatisë deklaratën dhe raportin e kontrollit të cilësisë, dhe t’ia përcjelli Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si institucion epror i saj.

*Në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr.254/7, datë 30.06.2015, nuk është zbatuar plotësisht rekomandimi nr.4 (masë për shpërblim dëmi): “Nga AKM të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumës **1,508,747 lekë**, përfutur padrejtësisht nga kontratat e lidhura me institucionet e monitorimit të treguesve mjedisor”. (Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 16-23, të Raportit të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Për rekomandimin nr.4 për shpërblim dëmi në vlerën e mbetur pa u arkëtuar prej **303,787 lekë** nga kontrata me IGJEUM, titullari i AKM-së të marrë masat e nevojshme dhe të ndjeki të gjitha procedurat ligjore (hapja e procesit gjyqësor) për arkëtimin e të drejtave të konstatuara ndaj këtij institucioni.

*Brenda muajit Dhjetor të vitit 2019*

**3. Gjetje nga auditimi:** Procedura e hartimit të projekt buxhetit afatmesëm 2015-2017; 2016-2018; 2017-2019; 2018-2020 është kryer nga AKM në kundërshtim me Kap.III, pika 40-45 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Programit”; pika 46-48 “Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit”, si dhe pika 49-55 “Përgjegjësitë e nëpunësit zbatues”, të Udhëzimit nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, në lidhje me respektimin e dy fazave nëpër të cilat kalon përgatitja e projekt buxhetit afatmesëm, si dhe në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimet vjetore plotësuese “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm”. (Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 23-41, të Raportit të Auditimit).

**3.1 Rekomandim:** Titullari i AKM-së, në rolin e drejtuesit të programit buxhetor “mbrojtja e mjedisit” të respektojë përcaktimet e bëra në Kap.III, pika 40-45 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Programit”; pika 46-48 “Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit”, si dhe pika 49-55 “Përgjegjësitë e nëpunësit zbatues”, të Udhëzimit nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, duke krijuar ekipin e menaxhimit të programit, si dhe përcaktimin e nëpunësit zbatues të AKM-së, në rolin e sekretarit të grupit për hartimin e projekt-buxhetit afat-mesëm dhe atij vjetor. Gjithashtu procedura e përgatitjes së buxhetit të sigurojë gjurmët e auditimit, ku çdo anëtar i grupit të menaxhimit të programit të dokumentojë me shkresë përcjellëse drejtuar sekretarit të grupit, kërkesat për fondet buxhetore.

*Në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Në kërkesat për fonde që ka përgatitur çdo drejtori e AKM-së, gjatë periudhës së përgatitjes së projekt-buxhetit, u vu re se mungonte një analizë ekonomiko-financiare, nuk detajoheshin kostot për çdo aktivitet që do të kryhej gjatë vitit, nuk përcaktoheshin objektivat si dhe risqet që rrezikonin arritjen e tyre, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me pikat 46-48 të Udhëzimit nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”. Materialet e përgatitura nga drejtuesit e drejtorive në AKM janë të pa nënshkruara, pa datë, dhe nuk i adresohen nëpunësit zbatues të AKM. Gjithashtu nga nëpunësi zbatues i AKM-së në lidhje me procesin e planifikimit të buxhetit, nuk janë kryer veprimet e nevojshme në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën nr.51, 52 dhe 53, të Udhëzimit të mësipërm. *(Më hollësisht trajtuar në faqe nr.23-41, të Raportit të Auditimit).*

**4.1 Rekomandim:** AKM në projekt-buxhetin përfundimtar që dërgon në MTM, të shoqërojë të gjitha kërkesat e saj për fonde me tregues statistikor të matshëm, për aktivitetin e çdo drejtorie, pra se sa leje mjedisore do të shqyrtohen gjatë një viti, sa vlerësime të ndikimit në mjedis do të kryhen, sa monitorime do të kryhen dhe çfarë treguesish do të monitorohen, nga AKM dhe nga institucionet me të cilat lidhë kontratat e monitorimit, për efekt llogaritjen e shpenzimeve për dieta si dhe të fondeve për kontratat e monitorimit.

*Në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Pasqyrat plotësuese që shoqërojnë projekt buxhetet 2015-2017; 2016-2018; 2017-2019; 2018-2020 nuk janë në përputhje me pikat 2-3, shkronja “f” të udhëzimeve vjetore plotësuese “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm”, konkretisht mungon pasqyra nr.7 për transfertat e brendshme sipas shtojcës 1/a, pasqyra nr.9 për transfertat në buxhetet familjare dhe individ, pasqyra nr.12 investimet e huaja sipas projekteve. *(Më hollësisht trajtuar në faqe nr.23-41, të Raportit të Auditimit).*

**5.1 Rekomandim:** AKM të respektojë kërkesat e përcaktuara në udhëzimet plotësuese vjetore, për përgatitjen projekt-buxhetit, lidhur me plotësimin e të gjithë pasqyrave financiare që kërkohen sipas shtojcave 1-6, të udhëzimeve përkatëse.

*Në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Për muajin Dhjetor të viteve 2015-2018 është vepruar në kundërshtim me pikën nr.151, të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe pikës 3, Kreu I, të Udhëzimeve plotësuese vjetore “Për zbatimin e buxhetit”, për mosrespektimin e prioritetit të radhës për pagesat e shpenzimeve të institucionit, të faturave të energjisë elektrike, uj, telefon, posta, etj. *(Më hollësisht trajtuar në faqe nr.23-41, të Raportit të Auditimit).*

**6.1 Rekomandim:** AKM të respektojë prioritetet e radhës për pagesat e shpenzimeve të institucionit, në përputhje me pikën nr.151, të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe përcaktimeve të bëra në Udhëzimet plotësuese vjetore për zbatimin e buxhetit, me qëllim edhe *eliminimin e efekteve negative financiare* që krijohen në buxhet, nga mospagesa në kohë e faturave për shpenzime operative (TVSH-së, tatim mbi të ardhurat).

*Në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Për vitet 2015-2018 nga AKM janë drejtuar ndaj Ministrisë së Mjedisit kërkesa për fonde shtesë, të cilat nuk janë hartuar në përputhje me nenin 45, të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe me pikën 71 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Në këto kërkesa nuk jepet informacion se përse një fond i tillë nuk është parashikuar në projekt-buxhetin përkatëse; Nuk jepet informacion se cilat do të jenë rezultatet e pritshme, sa do të jetë kontributi i shtesës së fondeve në realizimin e objektivave të vendosur, si dhe cilat mund të jenë risqet që rrezikojnë realizimin e tyre. *(Më hollësisht trajtuar në faqe nr.23-41, të Raportit të Auditimit).*

**7.1 Rekomandim:** AKM për çdo kërkesë për fonde shtesë drejtuar MTM gjatë vitit buxhetor, të respektojë përcaktimet e bëra në nenin 45, të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 71 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Çdo kërkesë për fonde shtesë të jetë e shoqëruar me një relacion ku të pasqyrohen arsyet për fonde shtesë, arsyet mos parashikimit gjatë planifikimit të buxhetit, kontributi që do të sjelli fondi shtesë në aktivitetet e AKM, si dhe risqet që mund të pengojnë realizimin e tyre.

*Në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Për vitet 2015-2018 nga AKM nuk është përgatitur raporti i monitorimit përfundimtar dhe raportet periodike të monitorimit të buxhetit, në kundërshtim me nenin 65, Kreu VIII të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me Kreun VI, pika 270, të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; me Kreun IV, pika 89 të Udhëzimit nr.2, datë 19.1.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”; me nenin 11 dhe 12, të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; si dhe me pikat 19-29, Kap. III, të Udhëzimit nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”. *(Më hollësisht trajtuar në faqe nr.23-41, të Raportit të Auditimit).*

**8.1 Rekomandim:** AKM për çdo vit buxhetor të përgatisë raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit, si dhe raportet periodike të zbatimit të tij.

*Në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Procedurat për marrjen në dorëzim të aktiveve (grante brenda sistemit dhe jashtë tij) për vitet 2015, 2017 dhe 2018, konkretisht: Aparaturë e tipit “TESTO”, viti **2015** në vlerën **1,187,760 lekë**; USB-së për përdorim dhe nënshkrim elektronik në vlerën **7,800 lekë**, si dhe Kompjuter PC (3 copë), Monitor (3 copë) dhe UPS (3 copë) në vlerën **368,313 lekë** totali, për vitin **2017**; Materialeve laboratorike nga projekti IBECA (mostra certifikuese referenc, kapa, standarde laborator, helium, argon, azot, acid klorhidrik) në vlerën **3,041,353 lekë** totali si dhe materialeve elektronike, program kompjuterik (1 copë), kompjuter philips (1 copë), aparat fotografik dixhital sony (6 copë), video-projektor (1 copë), laptop (1 copë), aparat dore GPS (6 copë), në total **3,965,484 lekë** për vitin **2018**, nuk janë kryer në përputhje me përcaktimet e bëra në Aneksin 1, klasa 2, “Aktivet afatgjata”, të Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, me pikën 42, 43, 55 dhe 56 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqe nr.50-55, të Raportit të Auditimit).*

**9.1 Rekomandim:** Nga titullari i AKM-së, në rolin e Nëpunësit Autorizues të respektohen përcaktimet e bëra në pikat 42, 43, 55 dhe 56 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku në krijimin e komisioneve të marrjes në dorëzim të aktiveve, të mbahet në konsideratë, që komisioni të ketë specialist të fushës në përbërje të tij, në varësi të llojit të aktiveve që merren (elektronike, laboratorike, etj).

*Në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Për vitet 2015-2018, u konstatua se vlerat e aktiveve të institucionit, të pasqyruara në raportet e inventarizimit 2015-2018 dhe pasqyrat financiare 2015-2018, kanë diferenca në vlerat, si vijon: **4,130,209 lekë**-viti 2015; **2,863,426 lekë**-viti 2016; **1,394,216 lekë**-viti 2017; **1,839,945 lekë**-viti 2018, të cilat rezultuan në llogarinë 214 “instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, si dhe në llogarinë 31, 32, 33, klasa 3 “gjëndja e inventarit”, ku në pasqyrat financiare ishin kontabilizuar me vlerë më të ulët në krahasim me vlerat e inventarit. Gjithashtu rezultoi se në asnjë prej viteve 2015-2018, nga komisionet repsektive të inventarizimit të aktiveve të AKM-së, nuk janë pasqyruar diferencat dhe më pas të mbaheshin procesverbalet për këto diferenca, duke vepruar në kundërshtim me pikën 85, shkronja “b” dhe “c” të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. *(Më*

*hollësisht trajtuar në faqe nr.50-55, të Raportit të Auditimit).*

**10.1 Rekomandim:** Nga titullari i AKM-së, të merren masat e nevojshme për sistemimin e diferencave të aktiveve, të rezultuara nga procesi i inventarizimit, si dhe të bëhet kontabilizimi i saktë i tyre në pasqyrat financiare, sipas llogarive përkatëse. Gjithashtu në procesin e inventarizimit, komisionet përkatëse, të bëjnë rakordimet e vlerave të aktiveve të rezultuara nga ky proces me ato të pasqyrave financiare, dhe për çdo diferencë të mbajnë procesverbal.

*Në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga AKM për kontratat e periudhës 2015-2018, nuk është respektuar grafiku i lëvrimit të fondeve, konkretisht për këstin e parë, i cili, sipas kontratës, duhej të lëvrohej në datën e nënshkrimit të saj nga palët, dhe jo me vonesë 10-15 ditë. *(Më hollësisht trajtuar në faqe nr.139-156, të Raportit të Auditimit).*

**11.1 Rekomandimi:** AKM për kontratat e monitorimit që do të nënshkruajë në të ardhmen, të marri masat e nevojshme që të respektojë grafikun e lëvrimit të fondeve sipas përcaktimeve të bëra në kontratë. Gjithashtu mënyra e pagesës së fondeve nga AKM ndaj institucioneve të monitorimit, të kryhet çdo herë pasi ato kanë sjellë dokumentin financiar justifikues, të plotë dhe të saktë në përmbajtje.

*Në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën 2015-2016, një pjesë e konsiderueshme e raporteve përfundimtare financiar dhe teknik, nga institucionet e monitorimit janë dorëzuar në AKM, **pa datë dhe pa numër protokolli**, në kundërshtim me formatin e përcaktuar në kontratë, ku specifikohet se raportimet financiare dhe teknike, dorëzohen në AKM me shkresë përcjellëse, me numër protokolli dhe datë, duke e bërë të pamundur sigurimin dhe ruajtjen e gjurmëve të auditimit të këtij veprimi. *(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 139-156, të Raportit të Auditimit).*

**12.1 Rekomandim:** AKM në rastet kur raportimet tekniko-financiare të institucioneve të monitorimit, dorëzohen pranë zyrave të saj pa shkresë përcjellëse (me datë dhe numër protokolli), t'i refuzojë dhe të vendosi penalitete për çdo rast.

*Në vijimësi*

**12.2 Rekomandim:** AKM të kryejë kontrole të herë pas hershme gjatë vitit për punën e kryer nga institucionet monitorimin e mjedisit, me të cilat ajo lidh kontrata shërbimi, kryesisht në rastet kur kryhen analiza laboratorike për monitorimin e ujrave nëntokësor, cilësinë e ujrave bregdetar, cilësinë e ajrit, etj, me qëllim rritjen e efektivitetit të fondeve të shpenzuara.

***Për çdo kontrat të nënshkruar, minimalisht 2 kontrole gjatë vitit***

**13. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën 2015-2018, projekt-propozimet e dërguar në AKM nga institucionet që do të kryejnë monitorimin e cilësisë dhe gjëndjes së mjedisit (ISHP, SHGJSH, UBT, etj), nuk është pasqyruar informacioni në përputhje me përcaktimet e bëra në Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit 2015-2018, si dhe këto institucione janë kualifikuar fituese, nga grupet e punës së AKM-së, të ngritura për shqyrtimin e këtyre projekt-propozimeve. *(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 139-156, të Raportit të Auditimit).*

**13.1 Rekomandim:** AKM të respektojë kërkesat e përcaktuara në PKMM-të e çdo viti, në lidhje me informacionin që duhet të dorëzojnë institucionet e monitorimit, në projekt-propozimet e tyre për kryerjen e shërbimit të monitorimit.

*Në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast, referuar regjistrin të raportimeve, subjekti "P.M" shpk, i pajisur me Leje Mjedisore të **Tipit A**, nuk ka përmbushur detyrimin për të raportuar mbi përmbushjen e kushteve të lejes mjedisore. Nga AKM, nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar ISHMPU, me qëllim vendosjen e penaltetit për mosrespektimin e kushteve të lejes nga subjekti "P.M" shpk. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 1/b.i, neni 29, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e



shtetit në vlerën rreth **3,900,000 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.82-139, të Raportit të Auditimit).

**14.1 Rekomandim:** AKM në zbatim të pikës 1/b.i, dhe pikës 3 neni 29, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, të marrë masa dhe të rillogarisë detyrimin finaciar sipas kriterëve ligjore, si dhe të bashkëpunojë me ISHPMU, për vlerësimin e rëndësisë së shkeljes nga subjekti privat, duke konkluduar me vendosjen e penaltetit për “**P.M**” shpk, në vlerën rreth **3,900,000 lekë**, ti propozojë Ministrin të MTM-së për revokimin e lejes mjedisore, si pasojë e mos përmbushjes të kushteve të lejes mjedisore nga subjekti.

*Menjëherë*

**15. Gjetje nga auditimi:** Në 8 raste, referuar regjistrin të raportimeve, 8 subjekte të cilët janë pajisur me Leje Mjedisore të **Tipit A**, nuk kanë raportuar për shkarkimin e ndotësve, sipas kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore të miratuar për subjektin. Nga AKM nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar ISHMPU, me qëllim vendosjen e penaltetit për mosrespektimin e kushteve të lejes nga subjektet “**E**” shpk, “**V**” shpk, “**A**” shpk, “**V.M**” shpk, “**F**” shpk; “**B.G**” shpk; “**T. A. T**” shpk, “**R.E**” shpk. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 1/a, neni 69, të Ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën rreth **135,900,000 lekë**, për mos përmbushjen e kushteve të lejes mjedisore. (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.82-139, të Raportit të Auditimit).

**15.1 Rekomandim:** AKM në zbatim të pikës 1/b.i, dhe pikës 3 neni 29, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, të marrë masa dhe të rillogarisë detyrimin finaciar sipas kriterëve ligjore, si dhe të bashkëpunojë me ISHPMU, për vlerësimin e rëndësisë së shkeljes nga subjekti privat, duke konkluduar me vendosjen e penaltetit për 8 subjektet “**E**”, “**V**” shpk, “**A**” shpk, “**V.M**” shpk, “**F**” shpk; “**B.G**” shpk; “**T. A. T**” shpk, “**R.E**” sipas vlerave përkatëse, ti propozojë Ministrin të MTM-së për revokimin e lejes mjedisore, si pasojë e mos përmbushjes të kushteve të lejes mjedisore nga subjektet.

*Menjëherë*

**16. Gjetje nga auditimi:** Në 6 raste, referuar regjistrin të raportimeve, 6 subjekte të cilët janë pajisur me Leje Mjedisore të **Tipit B**, nuk kanë raportuar për shkarkimin e ndotësve, sipas kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore të miratuar për subjektin. Nga AKM nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar ISHMPU, me qëllim vendosjen e penaltetit për mosrespektimin e kushteve të lejes nga subjektet “**Z**” shpk, “**3P.L**” shpk, “**V.R**” shpk, “**D.T**” shpk, “**P.D**” shpk dhe “**A.2014**” shpk. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 1/a, neni 69, të Ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën rreth **123,840,000 lekë** për mos përmbushjen e kushteve të lejes mjedisore. (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.82-139, të Raportit të Auditimit).

**16.1 Rekomandim:** AKM në zbatim të pikës 1/b.i, dhe pikës 3 neni 29, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, të marrë masa dhe të rillogarisë detyrimin finaciar sipas kriterëve ligjore, si dhe të bashkëpunojë me ISHPMU, për vlerësimin e rëndësisë së shkeljes nga subjekti privat, duke konkluduar me vendosjen e penaltetit për 6 subjektet, “**Z**” shpk, “**3P.L**” shpk, “**V.R**” shpk, “**D.T**” shpk, “**P.D**” shpk dhe “**A.2014**” shpk, sipas vlerave përkatëse, ti propozojë Ministrin të MTM-së për revokimin e lejes mjedisore, si pasojë e mos përmbushjes të kushteve të lejes mjedisore nga subjektet.

*Menjëherë*

**17. Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast, subjekti “**A**” shpk, pajisur me Leje Mjedisore Tipi B, *me nr. Identifikimi të Lejes*, sipas Akt-miratimit nr.5595, datë 01.09.2016, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: “*Nxjerrje e mineraleve, rërës, argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret*”. Nga auditimi i kësaj dosje konstatohet se Aplikimi i bërë për rishikim të kushteve të lejes mjedisore Tipi B viti 2010, është pranuar nga AKM jashtë afatit 2 vjeçar për paraqitjen e kërkesave për rishikim të kushteve të lejes të subjekteve ekzistuese në kundërshtim me pikën 2 e

nenit 30 të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”. (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.82-139, të Raportit të Auditimit).

**17.1 Rekomandim:** AKM të marrë masa për fillimin e procedurave, për revokimin e lejes mjedisore në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” ndaj subjektit “A” shpk, pajisur me Leje Mjedisore Tipi B, **me nr. Identifikimi të Lejes**, sipas Akt-miratimit nr.5595, datë 01.09.2016.

*Menjëherë*

**18. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën 2015-2018 është konstatuar se vlera e detyrimeve të AKM-së, pasqyruar në Pasqyrat Financiare sipas përllogaritjeve të bëra nga institucioni janë të gabuara dhe nuk pasqyrojnë informacion të saktë dhe real, në kundërshtim me Ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimin të Ministrisë së Financave “Për procedurat e përgatitjes dhe mbylljes së pasqyrave financiare për institucionet qendrore, njësitë e qeverisjes vendore, njësitë e tyre të varësisë dhe njësitë e zbatimit/implementimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë huaj”, si më posht vijon:

-**Viti 2015.**Vlera e detyrimeve të AKM-së, pasqyruar në Pasqyrën Financiare sipas përllogaritjeve të bëra nga institucioni është **3,470,261 lekë sipas përllogaritjeve të bëra nga AKM**, sipas përllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit, vlera totale e detyrimeve është **7,553,754 lekë**.

-**Viti 2016.**Vlera e detyrimeve të AKM-së, sipas përllogaritjeve të bëra nga institucioni është **3,532,365 lekë**, sipas përllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit, vlera totale e të drejtave është **4,424,750 lekë**.

-**Viti 2017.**Vlera e detyrimeve të AKM-së, sipas përllogaritjeve të bëra nga institucioni është **4,317,213 lekë**, sipas përllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit, vlera totale e të drejtave është **4,636,073 lekë**.

-**Viti 2018.**Vlera e detyrimeve të AKM-së, sipas përllogaritjeve të bëra nga institucioni është **4,297,896 lekë**, sipas përllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit, vlera totale e të drejtave është **5,186,320 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.55-69, të Raportit të Auditimit).

**18.1 Rekomandim:** Nga titullari i AKM-së, të merren masat e nevojshme për sistemimin e diferencave që rezultojnë në detyrimet që ka AKM ndaj të tretëve, si dhe të bëhet kontabilizimi i saktë i tyre në pasqyrat financiare, sipas llogarive përkatëse.

*Brenda muajit Dhjetor 2019*

**19. Gjetje nga auditimi:** Grupi i auditimit të KLSH-së, ka konstatuar mbivlerësim të llogarive financiare konkretisht për vitin 2015 dhe 2016, të llogarisë:

-7211, klasa 7 “grante nga organizata ndërkombëtare”, në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2015, është e mbivlersuar në vlerën **4,877,632 lekë**, ndërkohë sipas akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin në fund të vitit, si dhe lëvizjet “CASH”, pasqyra formati 5, kreu II, grupi 2, rezulton se të ardhurat e AKM-së janë **3,924,646 lekë**;

-Në grupin “aktive të qëndrueshme të trupëzuara” llogaria 211 “pyje, kullota, plantacione” në vlerën **227,895,696 lekë**. Konkretisht vlera **227,895,696 lekë**, që është akorduar nga buxheti i shtetit AKM-së për realizimin e procesit “Luftimi mekanik i procesionares së pishës së zezë në shkallë vendi”, referuar dhe pagesave të kryera në thesar, rezulton se është përdorur për mbulimin e shpenzimeve operative të tilla si: **Karburant; Dieta; Paga punonjësish të kontraktuar për kryerjen e shërbimeve të luftimit mekanik të procesionares; Shpërblime; Sigurime shoqërore, shëndetësore dhe tatim mbi të ardhurat**. Theksojmë se në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me krijimin e aseteve të qëndrueshme të trupëzuara ose të patrupëzuara. -Të llogarisë 7211, klasa 7 “grante nga organizata ndërkombëtare”, në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2016, është e mbivlerësuar në vlerën 4,620,253 lekë, ndërkohë sipas akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin në fund të vitit, si dhe lëvizjet “CASH”, pasqyra formati 5, kreu II, grupi 2, rezulton se të ardhurat e AKM-së janë 1,632,494 lekë. (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.55-69, të Raportit të Auditimit).

**19.1 Rekomandim:** Nga titullari i AKM-së, të merren masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë dhe real të llogarive **7211** dhe **211** në pasqyrat financiare.

*Brenda muajit Dhjetor 2019*

**20. Gjetje nga auditimi:** Grupi i auditimit për periudhën 2015-2018, ka konstatuar përlllogaritje të gabuar të vlerës së amortizimit për aktivet e institucionit, si më poshtë vijon:

-**Viti 2015.** Vlera e amortizimit e përlllogaritur nga AKM është **7,625,263 lekë**, ndërkohë vlera e amortizimit për aktivet e institucionit, përlllogaritur nga grupi i auditimit, është **10,597,694 lekë**.

-**Viti 2016.** Vlera e amortizimit e përlllogaritur nga AKM është **5,978,752 lekë**, ndërkohë vlera e amortizimit për aktivet e institucionit, përlllogaritur nga grupi i auditimit, është **5,968,274 lekë**.

-**Viti 2017.** Vlera e amortizimit e përlllogaritur nga AKM është **15,134,094 lekë**, ndërkohë vlera e amortizimit për aktivet e institucionit, përlllogaritur nga grupi i auditimit, është **11,912,707 lekë**.

-**Viti 2018.** Është konstatuar përlllogaritje e gabuar nga AKM të vlerës së amortizimit për aktivet e njësisë, konkretisht vlera e amortizimit e përlllogaritur nga AKM është **52,317,494 lekë**, sepse ka llogaritur në mënyrë të gabuar amortizim në vlerën **45,571,139 lekë** (227,895,696 lekë vlera e projektit\*20%) për projektin **“luftimi mekanik i procesionares së pishës së zezë”**, të cilën siç e kemi cituar edhe më sipër nuk është investim në aktive afatgjata të trupëzuara apo të patrupëzuara. Ndërkohë vlera e amortizimit për aktivet e institucionit, përlllogaritur nga grupi i auditimit, është **19,361,290 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.55-69, të Raportit të Auditimit).

**20.1 Rekomandim:** Titullari i AKM-së, të marri masat e nevojshme për përlllogaritjen e saktë të vlerës së amortizimit të aktiveve të institucionit dhe kontabilizimin e saktë dhe real të tyre në pasqyrat financiare.

*Brenda muajit Dhjetor 2019*

**21. Gjetje nga auditimi:** Në **5 raste** konstatohet se emërimi i punonjësve të AKM-së, është kryer në kundërshtim me përcaktimet e bëra në seksionin 4.1.2 **“Ilustrimi hap pas hapi i procesit të hartimit të përshkrimeve të punës”**, tek pika 3 e tij **“Përcaktoni fushën dhe nivelin e studimit të kërkuar për këtë pozicion pune”**, të Udhëzimit nr.1 datë 31.05.2017 të Departamentit të Administratës Publike, përsa i përket fushës dhe nivelit të studimit të kërkuar për pozicionet e përshkruara të punës në rregulloren e brendshme të saj, si më poshtë vijon:

1. **znj.B.T** (Përgjegjëse e sektorit të lejeve mjedisore);
2. **z.N.P** (Drejtor i Drejtorisë së Informacionit dhe Statistikave);
3. **z.G.Rr** (Specialisti II i Sektorit të Regjistrimit të Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve);
4. **z.A.K** (Specialisti i sektorit të GIS, IT, SIM dhe Inovacionit);
5. **z.F.P** (Përgjegjëse e sektorit të Cilësisë së Mjedisit). (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.41-49, të Raportit të Auditimit).

**21.1 Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i AKM të marrë masa, në bazë të **VKM nr.142, datë 12.3.2014** **“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”**, Lidhja 2/2. **“Përshkrimi i përgjithshëm i punës dhe kërkesat për pranimin në çdo klasë”**, Klasa III-B të **“Kërkesa të posaçme”**, njohuri dhe aftësi: **“Njohuri shumë të mira të specialiteteve brenda një fushe të caktuar profesionale dhe të politikave e programeve lidhur me fushën e specialitetit”** si dhe Klasa IV/-a të **“Kërkesa të posaçme”**, njohuri dhe aftësi: **“Dije të përgjithshme të parimeve, koncepteve, metodave dhe teknikave të një profesioni, të mjaftueshme për të realizuar detyrat e pozicionit”**, bazuar në shkeljet e konstatuara të informojë DAP që këto vende të plotësohen me punonjës që fusha dhe niveli i studimit të përshtaten me fushën e specialitetit të vendit të punës. Të shihet mundësia që punonjësit e mësipërm të përshtaten në vende me përshkrim pune të njëjtë me fushën e arsimimit të tyre pranë AKM.

*Brenda muajit Dhjetor të vitit 2019*

**22. Gjetje nga auditimi:** AKM në **11 raste**, përsa i përket numrit të punonjësve, ka mosplotësim të vendeve të punës në AKM me **3 punonjës** dhe në DRM e rretheve në nivele drejtuese dhe

specialist me **8 punonjës**. Si rrjedhojë krijohet vakum në realizimin e detyrave të AKM nga punonjësit që mungojnë bazuar në detyrat që ato kanë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të AKM miratuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit me shkresën me nr prot 10/3/1 datë 06.03.2019. Kështu përta i përket lejeve të ndërtimit bazuar në rregulloren e brendshme vendi i specialistit që i shqyrton është bosh, dhe këto detyra i shqyrtojnë specialistët e tjerë brenda drejtorisë që nuk e kanë atë detyrë. Kjo bie në kundërshtim me *udhëzimin nr 1 datë 31.05.2017 të Departamentit të Administratës Publike, ku në seksionin nr 1 thuhet “Përshkrimi i punës shërben për ta njohur nëpunësin me punën konkrete që do të kryejë”.* (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.41-49, të Raportit të Auditimit).

**22.1 Rekomandim:** Drejtorja e Personelit në AKM të marrë masa, në bazë të Vendimit nr.242, datë 18.03.2015 i ndryshuar me vkm nr. 748, datë 19.12.2018 “ *Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” të plotësojë sa më shpejt vendet vakante në AKM dhe DRM e rretheve në mynyrë që secili punonjës të okupohet vetëm me detyrat e përshkruara në rregulloren e brendshme sipas pozicionit të punës.

### ***Brenda muajit Dhjetor të vitit 2019***

**23. Gjetje nga auditimi:** AKM ka kryer 2 inspektime të përbashkëta me organet e tjera të kontrollit si ISHMPU Tiranë, AKZM, IKMT, organet e NJVQV etj, në zonat me probleme mjedisore në zonat me probleme mjedisore. Bashkëpunimet e AKM me organet e tjera të kontrollit janë realizuar vetëm mbi bazë të Urdhrit të Ministrit. Nga këto inspektime nuk disponohet informacion i plotë në AKM në lidhje me punën e kryer nga specialisti i lejeve mjedisore **z.K.S** në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit me nr.1316. Kjo bie në kundërshtim me rregulloren e brendshme ku përgjegjësi i sektorit të lejeve mjedisore në Drejtorinë e Gjendjes & Cilesise se Mjedisi ka për detyrë “*Pika h, raporton tek eprorët në lidhje me ecurinë e punës së sektorit*”. Titullari i AKM-së, për çdo rast ku specialistët e AKM-së marrin pjesë në inspektime të përbashkëta me institucione të tjera, të marri masat e nevojshme, që informacioni mbi inspektimet e kryera dhe penalitetet e vendosura të protokollohet pranë zyrës së protokollit të AKM-së, duke ruajtur në këtë mënyrë edhe gjurmët e auditimit (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.156-158, të Raportit të Auditimit).

**23.1 Rekomandim:** Titullari i AKM-së, për çdo rast ku specialistët e AKM-së marrin pjesë në inspektime të përbashkëta me institucione të tjera, të marri masat e nevojshme, që informacioni mbi inspektimet e kryera dhe penalitetet e vendosura të protokollohet pranë zyrës së protokollit të AKM-së, duke ruajtur në këtë mënyrë edhe gjurmët e auditimit.

### ***Në vijimësi***

**24. Gjetje nga auditimi:** Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për periudhën 2015-2018, përta i përket kontratatave të lidhura me AKM, për kryerjen e monitorimit të mjedisit, ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e bëra në kontratat përkatëse, ku për vitin 2015, 2016, 2018 nuk ka dorëzuar formularin e deklarimit që zotëron të gjitha kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës, projekt propozimet e dorëzuara prej tij nuk janë në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 5 dhe 6 të VKM nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, si dhe me përcaktimet e bëra në Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit në kapitullin 2.1 dhe 2.2. (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.139-156, të Raportit të Auditimit).

**24.1 Rekomandim:** Grupi i auditimit i rekomandon Titullarit të AKM-së, të marri të gjitha masat e nevojshme për të pezulluar financimin e kontratatave të lidhura me SHGJSH për monitorimin e ujërave nëntokësor për vitin 2019, deri në auditimin e plotë të këtij projekti nga KLSH pranë SHGJSH-së, nëpërmjet një auditimi tematik, pas miratimit nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

### ***Menjëherë***

## **C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues), të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë administrative dhe ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e demit në vlerën **1,976,104 lekë** në total. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e demit, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në 2 raste, referuar regjistrin të raportimeve, 2 subjekte të cilët janë pajisur me Leje Mjedisore të **Tipit B**, nuk kanë përmbushur detyrimin për të raportuar mbi përmbushjen e kushteve të lejes mjedisore. Nga AKM nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar ISHMPU, me qëllim vendosjen e penaltetit për mosrespektimin e kushteve të lejes nga subjektet **"I"** shpk, **"A"** shpk. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 1/b.ii, neni 29, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën rreth **1,200,000 lekë, e ndarë respektivisht në 720,000 lekë për “I” shpk dhe 420,000 lekë për “A” shpk.** (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.82-139, të Raportit të Auditimit).

**1.1 Rekomandim:** AKM në zbatim të pikës 1/b.i, dhe pikës 3 neni 29, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, të marrë masa dhe të rillogarisë detyrimin finciar sipas kriterëve ligjore, si dhe të bashkëpunojë me ISHPMU, për vlerësimin e rëndësisë së shkeljes nga subjekti privat, duke konkluduar me vendosjen e penaltetit për **"I"** shpk dhe **"A"** shpk sipas vlerave përkatëse, ti propozojë Ministrit të MTM-së për revokimin e lejes mjedisore, si pasojë e mos përmbushjes të kushteve të lejes mjedisore nga subjekte, si dhe të kërkojë në rrugë administrative dhe gjyqësore arkëtimin e vlerës **1,200,000 lekë, e ndarë respektivisht në 720,000 lekë për “I” shpk dhe 420,000 lekë për “A” shpk si të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.**

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën **Janar-Mars 2015** janë shpenzuar në mënyrë të padrejtë shpenzime për dieta në vlerën **33,000 lekë, duke shkaktuar dëm ekonomik në buxhetin e shtetit**, të cilat kanë pasaktësi në dokumentacion dhe shërbime të paguara për punonjës të paautorizuar, në programet e punës të miratuar nga Titullari i AKM-së, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën b, pika 35 dhe pika 36 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, si dhe me përcaktimet e bëra në shkronjën b, pika 3, KREU III, dhe KREU IV, të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.23-41, të Raportit të Auditimit).

**2.1 Rekomandim:** Titullari i AKM-së të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **33,000 lekë**, shpenzime për dietat për punonjësit e AKM-së, për **z.S.B** (16,500 lekë), **znj. S.P** (5,500 lekë), **znj.E.C** (5,500 lekë) dhe **znj.Sh.B** (5500 lekë).

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Si pasojë e mosvendosjes së penaltetit ndaj subjektit “A.G” shpk, për mos realizim të punimeve sipas grafikut të punimeve për vitin 2016, referuar kontratës nr. **1949, prot.**, datë **08.08.2016, është shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit** vlera prej **13,411 lekë** (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.23-41, të Raportit të Auditimit).

**3.1 Rekomandim:** Titullari i AKM-së të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **13,411 lekë**, ndaj Nëpunësit Zbatues të AKM-së, përgjegjës për këtë periudhë.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Për kontratën nr.107 (monitorimi i erozionit të tokës), me vlerë financimi **700,000 lekë**, UBT ka dorëzuar raportin financiar përfundimtar në datën **16.12.2015**, dhe jo sipas afatit të përcaktuar në kontratë, në datën **01.12.2018**, pra **11** ditë pune me vonesë. Për këtë veprim të UBT, nga AKM duhet të ishte llogaritur penaltet në vlerën: 11 ditë vonesë \* (4/1000\*700,000 lekë)=**30,800 lekë**, vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr.139-156, të Raportit të Auditimit*).

**4.1 Rekomandim:** Titullari i AKM të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **30,800 lekë**, për mosvendosjen e penaltetit ndaj SHGJSH, për dorëzimin 11 ditë me vonesë të raportit financiar përfundimtar.

*Menjëherë*

**5. Gjetje nga auditimi:** Janë konstatuar shpenzime për dieta në vlerën **15,000 lekë**, për anëtarët e grupit të monitorimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar të përbërë nga **z.A.Dh, z.A.G, z.S.O, znj.E.Ç dhe z.M.B**, të cilat kanë mangësi në dokumentacionin justifikues, konkretisht për udhëtimin në qytetin e Fierit, data e faturës së hotelit për anëtarët e grupit të monitorimit, nuk korrespondon me datën kur kanë dalë nga hoteli punonjësit si dhe me datën e shënuar në kuponin tatimor, si dhe **15,000 lekë**, konkretisht në urdhër shërbimit të **z.A.Dh, z.A.G, z.S.O, znj.E.Ç dhe z.M.B** (anëtar të grupit të monitorimit SHGJSH), të cilët dërgohen me shërbim në rrethin e Matit nga data 19.04.2018-20.04.2018 (1 net fjetje + 1 ditë për person = 3,000 + 2,500 lekë = 5,500 lekë/person, në total 27,500 lekë/5 persona), kuponi tatimor i lëshuar nga hoteli mban datën 19.04.2018, ndërkohë në faturë është data 20.04.2019, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën b, pika 35 dhe pika 36 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, si dhe me përcaktimet e bëra në shkronjën b, pika 3, KREU III, dhe KREU IV, të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 139-156, të Raportit të Auditimit*).

**5.1 Rekomandimi:** Titullari i AKM të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **30,000 lekë**, shpenzime për dietat për anëtarët e grupit të monitorimit **z.A.Dh, z.A.G, z.S.O, znj.E.Ç dhe z.M.B** dërguar me shërbim në qytetin e Fierit dhe Matit.

*Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** Janë paguar shpenzime për dieta nga AKM për grupin e monitorimit të ISHP të përbërë nga **znj.O.P, z.A.Sh, znj.Sh.T, z.B.A, z.A.K**, të cilat kanë problematikë në saktësinë e dokumentacionit justifikues, në vlerën **33,000 lekë**, si dhe **16,500 lekë** nga grupi i monitorimit të përbërë nga **znj.P.K, z.G.K**, si dhe **z.Z.S**, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën b, pika 35 dhe pika 36 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, si dhe me përcaktimet e bëra në shkronjën b, pika 3, KREU III, dhe KREU IV, të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 139-156, të Raportit të Auditimit*).

**6.1 Rekomandim:** Titullari i AKM për kontratat AKM-ISHP të vitit 2017, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **33,000 lekë**, shpenzime për dieta për grupin e monitorimit të përbërë nga **znj.O.P, z.A.Sh, znj.Sh.T, z.B.A, z.A.K** dhe **16,500 lekë** për grupin e monitorimit të përbërë nga **znj.P.K, z.G.K**, si dhe **z.Z.S**.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nuk është respektuar detyrimi i kontratës nga ISHP për dorëzimin e raportit teknik të pjesshëm në datën 05.06.2017, për të cilën nga AKM nuk është vendosur asnjë

penalitet, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit, e për rrjedhojë konsiderohet dëm ekonomik në vlerën **174,606 lekë**, konkretisht: **22 ditë** vonesë (5 Qershor – 5 Korrik data tjetër e dorëzimit të raportit) \* (4/1000\*1,984,160 lekë)= **174,606 lekë** (Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 139-156, të Raportit të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Titullari i AKM për kontratën AKM-ISHP nr.1320 viti 2017, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **174,606 lekë**, për mosvendosjen e penalitetit ndaj ISHP, për dorëzimin 22 ditë me vonesë të raportit teknik të pjesshëm në datën 05.06.2017.

*Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi detyrimet që kanë institucionet e monitorimit ndaj AKM-së, është konstatuar vlera prej **303,787** lekësh detyrim i prapambetur nga kontrata e monitorimit me **Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM)**, në vitin 2014, vlerë të cilën AKM e ka njohur si të drejtë për tu arkëtuar, por rezulton se AKM deri në fund të vitit 2018, nuk ka marrë asnjë masë për arkëtimin e saj, **duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit e për pasojë do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën 303,787 lekë** (Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 55-69, të Raportit të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** Titullari i AKM-së për kontratën AKM-IGJEUM viti 2014, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **303,787** lekë, detyrim i prapambetur nga kontrata me IGJEUM.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Në 3 raste konstatohet se subjektet që kanë riaplikuar për leje mjedisore kanë paraqitur si mandat pagese mandatin e *aplikimit për të cilën AKM më parë është shprehur me “Refuzim” të lejes mjedisore*. Vlerësojmë se jemi përpara mos përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në pikën 3/a të VKM 417, datë 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve mjedisore” nga ana e subjekteve “**B.G**”, “**E**” dhe “**J.F**”. mos përmbushja e detyrimeve të përcaktuara në VKM 417/2014 në vlerën **130,000 lekë përbën të ardhur të munguar për buxhetin e shtetit, me efekt dëm ekonomik** (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.82-139, të Raportit të Auditimit).

**9.1 Rekomandim:** AKM të marrë masa duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit për vlerën totale **130,000 lekë, përkatësisht për “B.G”, “E” dhe “J.F”** për arkëtimin e vlerës prej e vlerës prej **130,000** lekë për secilin subjekt.

*Menjëherë*

**10. Gjetje nga auditimi:** Janë paguar **11,000 lekë** dieta për punonjësën e SHGJSH, i cili ka kryer shërbime jashtë rrethit të Tiranës, të cilat kanë problematikë në dokumentacionin justifikues që i bashkangjitet Urdhër-Shërbimit, konkretisht në urdhër shërbimin në datë 28.10.2015-30.10.2015, ku dërgohet për shërbim punonjësi **z.H.B** në qytetin e Vlorës, fatura e hotelit e bashkangjitur në urdhër-shërbimin e punonjësit të mësipërm, ka emrin e një punonjësi tjetër **znj.S.M** dhe jo të atij të autorizuar për kryerjen e shërbimit përkatës, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën b, pika 35 dhe pika 36 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, si dhe me përcaktimet e bëra në shkronjën b, pika 3, KREU III, dhe KREU IV, të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 139-156, të Raportit të Auditimit).

**10.1 Rekomandim:** Titullari i AKM-së për konstatimin e mësipërm, në kontratën AKM-SHGJSH viti 2015 të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **11,000 lekë**, shpenzime për dietat për punonjësën e SHGJSH **z.H.B**.

**D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në prokurimin publik me objekt “Për mirëmbajtjen e pajisjeve të monitorit” për vitin 2016, me fond limit 8,187,578 lekë pa tvsh, KVO ka vepruar në papajtueshmëri me nenet 20, 23, 24, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu VII i VKM nr.914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke kualifikuar ofertues i cili nuk i plotëson kriteret për kualifikim. KVO nuk duhet të kishte shpallur fitues OE “K” shpk, dhe njëherazi duhet të kishte anuluar procedurën e prokurimit. Nga veprimet dhe mosveprimet e KVO, është shkaktuar përdorim i fondeve publike me efekt financiar negativ në vlerën 8,186,060 lekë pa tvsh (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.70-82, të Raportit të Auditimit).

**1.1 Rekomandim:** AKM, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me efekt financiar negativ në vlerën 8,186,060 lekë, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Menjëherë

**2. Gjetje nga auditimi:** AKM ka vepruar në kundërshtim me pikën 62, të Udhëzimit nr.2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe me nenin 12, pika 3, shkronja “gj” të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, për mos ekzekutimin e vendimeve të gjykatës, të formës së prerë, për 3 punonjësit e larguar nga puna, z.F.C 3.8 paga, znj.A.M 15.7 paga dhe z.D.K 19.7 paga, duke krijuar edhe efekt negativ financiar në vlerën 129,792.5 lekë në buxhetin e shtetit nga tatimi mbi të ardhurat e tyre i pa ndalur (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.55-69, të Raportit të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Titullari i institucionit, të marrë masa për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës të formës së prerë, për pagesën e 3 punonjësve të cituar më sipër, me qëllim shmangien e efekteve negative financiare që krijohen në buxhetin e shtetit.

Brenda muajit Dhjetor të vitit 2019

**3. Gjetje nga auditimi:** Në kontratën AKM-ISHP nr.515, viti 2016, është bërë shtesë e vlerës së financimit të kontratës me 103,860 lekë, pra nga 1,856,650 lekë u bë 1,960,510 lekë. Kjo vlerë lekësh e shtuar ndaj totalit të vlerës fillestare, nuk është përfshirë në kontratën midis palëve nëpërmjet një amendimi të saj. Pra e thënë ndryshe këstet e financimit janë aplikuar mbi një vlerë monetare e cila nuk është përfshirë në kontratë, konkretisht nëse me këstin e parë lëvrohet 40% e fondit të kontratës, ligjërisht 40% duhet të aplikohet mbi vlerën 1,856,650 lekë dhe jo mbi vlerën 1,960,510 lekë, por ndërkohë ka ndodhur e kundërta, për të tre këstet e lëvrimit të fondeve 40%-I, 40%-II dhe 20%-III nga AKM në ISHP (Më hollësisht trajtuar në faqe nr.139-156, të Raportit të Auditimit).

**3.1 Rekomandim** Titullari i institucionit, për kontratën AKM-ISHP nr.515, viti 2016, të marrë masa për kthimin e shtesës së financimit të kontratës në vlerën 103,860 lekë, shumë e cila nuk ishte e përfshirë në kontratën midis palëve nëpërmjet amendimit të saj.

Brenda muajit Dhjetor të vitit 2019

**E. MASA DISIPLINORE**

**E.1** Mbështetur në nenin 15, shkronja “c” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”,



nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", si dhe në Kreun IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në kontratën individuale të punës i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës me statusin e nëpunësit civil dhe me kodin e punës, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore nga **“Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim”** për punonjësit e mëposhtëm:

1. **Z.F.K.**, (Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit Mjedisor) për miratimin e Lejes Mjedisore për 5 raste në kundërshtim me kërkesat dhe procedurën e përcaktuar në Kreun III dhe VI të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të Tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, shoqëruar edhe me shkaktimin e dëmit ekonomik, *trajtuar në fq., nr. 82-139 të Raportit të Auditimit*.
2. **Znj.D.D** (Drejtoreshë e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse), Për 2 raste për mosrespektimin e përcaktimeve e bëra në Kap.III, pika 49-55 “Përgjegjësitë e nëpunësit zbatues”, të Udhëzimit nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, *trajtuar në fq., nr. 23-41 të Raportit të Auditimit*; Për 1 rast për mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e detyrimit të IGJEUM ndaj AKM nga kontrata e monitorimit të mjedisit në vlerën 303,787 lekë, në rolin e nëpunësit zbatues, trajtuar në fq., nr.50-55 të Raportit të Auditimit; Për mos respektimin në 3 raste të porocedurave ligjore në mbajtjen dhe organizimin e kontabilitetit, duke sjell që pasqyrat financare të kenë gabime materiale të përhapura; Për mosrespektimin e Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, në një rast, procedurë dhurimi të aktiveve.
3. **Z.N.P**, (Drejtor i Informacionit dhe Statistikave) Për 1 rast si anëtare e KVO, ku është kualifikuar operatori ekonomik “Krijon” në papajtueshmëri me nenet 20, 23, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu VII i VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke i sjellë efekt financiar negativ buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në vlerën 8,186,060 lekë pa tvsh, *trajtuar në fq., nr.70-82 të Raportit të Auditimit*; Për 4 raste për mosrespektimin e përcaktimeve e bëra në Kap.III, pika 20-33 “Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit”, të Udhëzimit nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.
4. **Znj.B.T**, (Përgjegjëse e sektorit të lejeve mjedisore), për miratimin e Lejes Mjedisore për 20 raste në kundërshtim me kërkesat dhe procedurën e përcaktuar në Kreun III dhe VI të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të Tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, shoqëruar edhe me shkaktimin e dëmit ekonomik, si dhe *trajtuar në fq., nr. 82-139 të Raportit të Auditimit*; Për 1 rast si anëtare e KVO, ku është kualifikuar operatori ekonomik “Krijon” në papajtueshmëri me nenet 20, 23, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu VII i VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke i sjellë efekt financiar negativ buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në vlerën 8,186,060 lekë pa tvsh, *trajtuar në fq., nr. 70-82 të Raportit të Auditimit*;
5. **Znj.E.M**, (Përgjegjëse e sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis) për miratimin e Lejes Mjedisore për 16 raste në kundërshtim me kërkesat dhe procedurën e përcaktuar në Kreun III

- dhe VI të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, shoqëruar edhe me shkaktimin e dëmit ekonomik, *trajtuar në fq., nr. 82-139 të Raportit të Auditimit;*
6. **Znj.F.P** (përgjegjëse e sektorit të cilësisë së mjedisit) anëtar i grupit në 6 raste, për kualifikimin e projekt-propozimit jo në përputhje me kërkesat e PKMM 2016, pika 2.2, faqe nr.13, *trajtuar në fq., nr. 139-156 të Raportit të Auditimit;*
  7. **Z.B.H** (Përgjegjës i sektorit të inventarit kombëtar të pyjeve) anëtar i grupit në 6 raste, për kualifikimin e projekt-propozimit jo në përputhje me kërkesat e PKMM 2016, pika 2.2, faqe nr.13, *trajtuar në fq., nr. 139-156 të Raportit të Auditimit;*
  8. **Znj.V.Gj** (Përgjegjëse e sektorit të laboratorit) anëtar i grupit në 6 raste, për kualifikimin e projekt-propozimit jo në përputhje me kërkesat e PKMM 2016, pika 2.2, faqe nr.13, *trajtuar në fq., nr. 139-156 të Raportit të Auditimit;*
  9. **Znj.E.M**, (Përgjegjëse e Sektorit Regjistrit Shkarkimeve dhe transferimit të Mbetjeve) për një rast si anëtare e komisionit të prokurimit me vlera të vogla, ku nuk është administruar procesverbali për mos paraqitjen e operatorit të parë, por nga komisioni është bërë direkt njoftimin e operatorit të dytë, *trajtuar në fq., nr.71-83 të Raportit të Auditimit;*
  10. **Znj.R.S**, (Përgjegjëse sektori Finance) Për një rast si anëtar i komisionit të inventarizimit në një rast, për mos pasqyrimin e diferencave të konstatuara nga grupi i auditimit, dhe më pas të mbaheshin proces-verbale për diferencat e rezultuara, duke vepruar në kundërshtim me pikën 85, shkronja “b” dhe “c” të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, *trajtuar në fq., nr.50-55 të Raportit të Auditimit;* Për një rast si kryetare e komisionit të prokurimit me vlera të vogla, ku nuk është administruar procesverbali për mos paraqitjen e operatorit të parë, por nga komisioni është bërë direkt njoftimin e operatorit të dytë, *trajtuar në fq., nr.71-83 të Raportit të Auditimit;*
  11. **Znj.F.H** (Përgjegjëse e sektorit të shërbimeve mbështetëse) Për 2 raste si anëtare e Njesisë së Prokurimit për mos përcaktimin e kriterëve teknike rast pas rasti që duhet të plotësoj operatori ekonomik “Krijon” në për kryerjen e kontratës me objekt “mirëmbajtja e stacioneve të monitorimit të ajrit”, duke shmangur detyrimet e përcaktuara nga pikat 3, të nenit 28, 5/ç të Ligjit për prokurimin publik, *trajtuar në trajtuar në fq., nr. 70-82 të Raportit të Auditimit;*
  12. **Znj. A.C** Për 1 rast, si personi përgjegjës për ndjekjen e zbatimit teknik të kontratës së monitorimit të mjedisit midis AKM dhe ISHP, ku nga personi i cituar nuk është marrë asnjë masë për vendosjen e penaltetit ndaj ISHP për dorëzimin e raportit teknik të pjesshëm 22 ditë me vonesë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit, e për rrjedhojë konsiderohet dëm ekonomik në vlerën **174,606 lekë**, konkretisht: **22 ditë** vonesë (5 Qershor – 5 Korrik data tjetër e dorëzimit të raportit) \* (4/1000\*1,984,160 lekë)= **174,606 lekë**, *trajtuar në trajtuar në fq., nr. 139-156 të Raportit të Auditimit;*
  13. **Z.K.S** (Specialist në sektorin e Lejeve Mjedisore) për miratimin e Lejes Mjedisore për 12 raste në kundërshtim me kërkesat dhe procedurën e përcaktuar në Kreun III dhe VI të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, shoqëruar edhe me shkaktimin e dëmit ekonomik, *trajtuar në fq., nr. 82-139 të Raportit të Auditimit.*
  14. **Znj.A.P**, (Specialiste në sektorin e Lejeve Mjedisore) për miratimin e Lejes Mjedisore për 11 raste në kundërshtim me kërkesat dhe procedurën e përcaktuar në Kreun III dhe VI të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, shoqëruar edhe me shkaktimin e dëmit ekonomik, *trajtuar në fq., nr. 82-139 të Raportit të Auditimit.*
  15. **Znj.B.K**, (Specialiste në sektorin e Përgjegjësishë Mjedisore) për miratimin e Lejes Mjedisore për 7 raste në kundërshtim me kërkesat dhe procedurën e përcaktuar në Kreun III dhe VI të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, shoqëruar edhe me shkaktimin e dëmit ekonomik, *trajtuar në fq., nr. 82-139 të Raportit të Auditimit.*
  16. **Z.A.P**, (Specialist në sektorin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis) për miratimin e Lejes Mjedisore për 7 raste në kundërshtim me kërkesat dhe procedurën e përcaktuar në Kreun III dhe VI të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, shoqëruar edhe me shkaktimin e dëmit ekonomik, *trajtuar në fq., nr. 82-139 të Raportit të Auditimit.*

17. **Znj.J.M** (Specialiste në sektorin e Lejeve Mjedisore) për miratimin e Lejes Mjedisore për 6 raste në kundërshtim me kërkesat dhe procedurën e përcaktuar në Kreun III dhe VI të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, shoqëruar edhe me shkaktimin e dëmit ekonomik, *trajtuar në fq., nr. 82-139 të Raportit të Auditimit.*
18. **Znj.E.M**, (Specialiste në sektorin e Përgjegjësisë Mjedisore) për miratimin e Lejes Mjedisore për 6 raste në kundërshtim me kërkesat dhe procedurën e përcaktuar në Kreun III dhe VI të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, shoqëruar edhe me shkaktimin e dëmit ekonomik, *trajtuar në fq., nr. 82-139 të Raportit të Auditimit.*
19. **Znj.R.K** për miratimin e Lejes Mjedisore për 7 raste në kundërshtim me kërkesat dhe procedurën e përcaktuar në Kreun III dhe VI të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, *trajtuar në fq., nr. 82-139 të Raportit të Auditimit.*
20. **Znj.B.H** (specialist i sektorit të silvikulturës në AKM) Për një rast si anëtare e komisionit të mbikqyrjes dhe marrjes në dorëzim të punimeve përfundimtare nga subjekti “Alb Garden”, nga Projekti i Pyllëzimit të Elbasanit në objektet Gur i Zi dhe Krastë e Madhe, ku në proces-verbalin e hartuar nga 3 anëtarët nuk është pasqyruar saktësisht volumi i punimeve të kryera, *trajtuar në fq., nr.23-41 të Raportit të Auditimit;* Për një rast si anëtar i komisionit të inventarizimit në një rast, për mos pasqyrimin e diferencave të konstatuara nga grupi i auditimit, dhe më pas të mbaheshin proces-verbalet për diferencat e rezultuara, duke vepruar në kundërshtim me pikën 85, shkronja “b” dhe “c” të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, *trajtuar në fq., nr.50-55 të Raportit të Auditimit;*
21. **Z.E.I** (specialist i sektorit të inventarit të pyjeve në AKM) Për një rast si anëtar e komisionit të mbikqyrjes dhe marrjes në dorëzim të punimeve përfundimtare nga subjekti “Alb Garden”, nga Projekti e Pyllëzimit të Elbasanit në objektet Gur i Zi dhe Krastë e Madhe, ku në procese-verbalin e hartuar nga 3 anëtarët nuk është pasqyruar ralisht volumi i punimeve të kryera, *trajtuar në fq., nr.23-41 të Raportit të Auditimit;* Për një rast si anëtar i komisionit të inventarizimit në një rast, për mos pasqyrimin e diferencave të konstatuara nga grupi i auditimit, dhe më pas të mbaheshin proces-verbalet për diferencat e rezultuara, duke vepruar në kundërshtim me pikën 85, shkronja “b” dhe “c” të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, *trajtuar në fq., nr.50-55 të Raportit të Auditimit;*
22. **Z.Sh.Sh** (specialist i sektorit të inventarit të pyjeve në AKM) Për një rast si anëtar e komisionit të mbikqyrjes dhe marrjes në dorëzim të punimeve përfundimtare nga subjekti “Alb Garden”, nga Projekti e Pyllëzimit të Elbasanit në objektet Gur i Zi dhe Krastë e Madhe, ku në procese-verbalin e hartuar nga 3 anëtarët nuk është pasqyruar ralisht volumi i punimeve të kryera, *trajtuar në fq., nr.23-41 të Raportit të Auditimit;*
23. **Znj.Gj.F** (Specialiste në sektorin e laboratorit) Për 7 raste si anëtare e komisionit të vlerësimit të projekt-propozimeve të institucioneve monitoruese, për kryerjen e monitorimit të mjedisit, të cilët janë kualifikuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit për periudhën 2015-2018, *trajtuar në fq., nr. 139-156 të Raportit të Auditimit;* Për 2 raste si anëtare e Njësisë së Prokurimit për mos përcaktimin e kriterëve teknike rast pas rasti që duhet të plotësoj operatori ekonomik “Krijon” në për kryerjen e kontratës me objekt “mirëmbajtja e stacioneve të monitorimit të ajrit”, duke shmangur detyrimet e përcaktuara nga pikat 3, të nenit 28, 5/ç të Ligjit për prokurimin publik, *trajtuar në fq., nr. 70-82 të Raportit të Auditimit;*
24. **Znj. L.B** (Specialiste në sektorin e financës) Për 7 raste si anëtare e komisionit të vlerësimit të projekt-propozimeve të institucioneve monitoruese, për kryerjen e monitorimit të mjedisit, të cilët janë kualifikuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit për periudhën 2015-2018, *trajtuar në fq., 139-156 të Raportit të Auditimit;* Për 3 raste për akordimin e fondeve për shpenzime për dieta për grupet e monitorimit të mjedisit, të cilat kanë pasaktësi dhe mungesë në dokumentacionin justifikues.

**Menjëherë**

## **F. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL**

Për ish drejtuesit dhe ish punonjësit nuk rekomandojmë masa disiplinore, pasi nuk kemi adresim institucional për marrëdhënie pune në administratën publike. Masa disiplinore e propozuar nga ana jonë, në bazë të shkeljeve të konstatuara, do të ishte *“Vërëjtje me paralajmërim”* deri në *“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”*, sipas shkallës së përgjegjësisë, për **12 ish-punonjës**, përkatësisht për:

1. **Z.J.B**, ish Drejtor i Përgjithshëm i AKM, larguar në 23.11.2017;
2. **Znj.E.S**, Specialiste në sektorin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, larguar nga puna në datë 31.01.2016;
3. **Z.A.T**, Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit në Mjedis, larguar nga AKM në datën 26.10.2015;
4. **Znj.L.T**, Drejtoreshë e Drejtorisë së Vlerësimit Mjedisor, larguar nga puna në datë 06.02.2018;
5. **Znj.O.N**, Specialiste në sektorin e Lejeve Mjedisore, larguar nga punë në datë 19.09.2017;
6. **Znj.E.M**, Specialiste juriste, larguar nga puna në datë 08.02.2018;
7. **Znj.E.P**, Specialiste juriste, larguar nga puna në datë 14.01.2019;
8. **Znj.F.H**, Specialiste në sektorin e laboratorit, larguar nga puna në AKM në datë 01.08.2015;
9. **Z.K.D**, ish Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve, larguar nga AKM në datën 01.08.2015;
10. **Znj.M.O**, Nëpunës zbatues për periudhën 01.04.2016-23.01.2017;
11. **Znj.Zh.D**, Nëpunës zbatues deri në datën 27.01.2015;
12. **Z.D.B**, Nënpunës zbatues i AKM-së deri në datën 30.03.2016;

## **G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Agjencia Kombëtare e Mjedisit pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrim e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.*

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R I**